

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Industrial - Standard” SH.P.K

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë 12.11.2024, ortakun e vetem te poshtë shënuar:

1. **Z. Aris Goxha**, atësia Mihallaq, datëlindje 08.12.1981, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. Vaso Pasha, Pallati 21, Ap.Nr.22 me kartë identiteti ID nr. 033714301 dhe nr. personal I11208032C, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

ka vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1. Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Industrial - Standard” SH.P.K.**, në vijim referuar si **“Shoqëria”**.

NENI 2

BAZA LIGJORE

- 2.1. *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2. Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 3

SELIA



- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga “Dhimiter Kamarda”, pallati B. Line, Nr. pasurie 5/281 G-1, Tiranë, Shqipëri.

NENI 4 OBJEKTI

- 4.1. Objekti kryesor i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Importi dhe tregtimi i artikujve të ndryshëm industrial dhe komponenteve elektronikë me pakicë. Projektimi, asemblimi dhe konfigurimi i sistemeve SCADA dhe sistemeve të tjera informatike kompjuterike për industrinë. Projektme dhe zbatime në fushën e inxhinierisë elektrike dhe elektronike për industrinë energjetike edhe atë të naftës edhe gazit natyror. Planifikimi, zhvillimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja, për të tretët, të impianteve të energjisë së rinovueshme, automatizim/informatizim i proceseve civile dhe industriale. Impiante CCTV dhe akses-kontroli. Konsulencë teknike, studime fizibiliteti në fushat e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëria mund të kryej edhe çdo lloj aktiviteti tjetër ndihmës dhe të nevojshëm që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- 6.1. Kapitali themeltar i *Shoqërisë* është 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortaku Themelues i shoqërisë përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, në raport me kontributin e dhënë nga ortaku I vetëm në shoqëri.
- 6.3. Pjesa e kapitalit zotërohet si më poshtë:



- 1) Ortaku **Aris Goxha**, zotëron 100% (Njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 10.000 Lek (dhjetë mijë).

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1. Emërohet Administrator i *Shoqërisë Z. Aris Goxha*, atësia Mihallaq, datëlindje 08.12.1981, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. Vaso Pasha, Pallati 21, Ap.Nr.22 me kartë identiteti ID nr. 033714301 dhe nr. personal I11208032C, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë.
- 8.3. Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4. Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1. Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2. Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njejtën fuqi ligjore.

ORTAKU I VETEM

Z. Aris Goxha

